



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 3968/Prot.
2

Tiranë, më 9.8.2024

URDHËR

Nr. 1324, datë 9.8.2024

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KOMISIONIT TË LARTË DHE KOMISIONEVE TË ZAKONSHME TË
KARRIERËS"**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të pikës 2, shkronjës "f", të nenit 13, të ligjit nr.64/2014, datë 26.06.2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të pikës 7, të nenit 22, të ligjit nr.59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar,

URDHËR O J:

1. Miratimin e rregullore "Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të lartë dhe komisioneve të zakonshme të karrierës", bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij urdhri.
2. Përgjigjen për zbatimin e këtij urdhri: komisionet e karrierës, komandantët e forcave, komandanti i Komandës Mbështetëse, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, komandantët e njësive dhe reparteve të varësisë së drejtëpërdrejtë të MM-së dhe SHPFA-së, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Qendra e Personel Rekrutimit, drejtoritë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së.
3. Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr.886, datë 28.06.2021 "Për miratimin e rregullore për organizimin dhe funksionimin e komisionit të lartë dhe komisioneve të zakonshme të karrierës", shfuqizohet.
4. Ngarkohet QKMBFA, për publikimin e kësaj rregulloreje në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes.
5. Ndjekin zbatimin e këtij urdhri sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Pirro Mengu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË LARTË DHE
KOMISIONEVE TË ZAKONSHME TË KARRIERËS

Miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes

Nr 1324, datë 9/8/2024

Tiranë, 2024



KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave të punës që do të ndjekin dhe do të zbatojnë komisionet e karrierës për të vlerësuar oficerët dhe nënoficerët për përparimin në gradë dhe për ndjekjen e kurseve institucionale.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i rregullores është të sigurojë që vlerësimi dhe rekomandimi për gradimin dhe kualifikimin e oficerëve dhe nënoficerëve të jetë i drejtë, i paanshëm, objektiv, i barabartë dhe transparent.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **"Komisionet e karrierës"** janë pjesë përbërëse e procesit të vlerësimit të ushtarakëve për përparimin në gradë dhe kualifikimin e radhës.
2. **"Kurset institucionale"** janë pjesë përbërëse e sistemit të arsimit dhe kualifikimit të personelit ushtarak, me qëllim aftësimin e personelit oficer, nënoficer dhe ushtar, si dhe një nga kriteret ligjore kryesore për përparimin në gradë.
3. **"Kurset funksionale"** janë pjesë përbërëse e sistemit të arsimit dhe kualifikimit të personelit ushtarak, me qëllim aftësimin e personelit oficer, nënoficer në kryerjen e detyrës funksionale.
4. **"Lista e meritës"** është lista e klasifikimit të ushtarakëve sipas meritës, me pikë ose me notë, në rendin zbritës, në përfundim të procesit të vlerësimit nga komisioni i karrierës për përparimin në gradë dhe për kualifikimin.

KREU II KOMISIONET E KARRIERËS

Neni 4 Statusi

Komisionet e karrierës janë autoritete përgjegjëse për vlerësimin e ushtarakëve për përparimin në gradë, si dhe për ndjekjen e arsimit dhe të kualifikimit, të përcaktuara në politikën e arsimit të Forcave të Armatosura që shërbejnë për marrjen e gradës së radhës, sipas përcaktimeve të nenit 22, pika 1, të ligjit nr.59/2014, datë 12.6.2014 "Për karrierën e ushtarakut në Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 5

Llojet, përgjegjësia dhe vendi ku zhvillojnë veprimtarinë komisionet e karrierës

1. Llojet e komisioneve të karrierës objekt i kësaj rregullore janë:
 - a) Komisioni i Lartë i Karrierës (KLK)
 - b) Komisioni i Zakonshëm i Karrierës (KZK)

2. Përgjegjësia e komisioneve të karrierës:



- a) **Komisioni i Lartë i Karrierës**, është përgjegjës për shqyrtimin e ushtarakëve që plotësojnë kriteret ligjore për përparim në gradë dhe ndjekjen e kurseve të kualifikimit që shërbejnë për marrjen e gradës së radhës, e përkatësisht:
 - i) Oficerët për përparimin në gradë, “major/kapiten i rangut të tretë”, “nënkolonel/kapiten i rangut të dytë”, dhe “kolonel/kapiten i rangut të parë” dhe për kualifikim nga grada “kapiten” deri në gradën “nënkolonel”.
 - ii) Nënoficerët për marrjen e gradave “kapter”, dhe “kryekapter”, dhe personelin nënoficer me gradën “rreshter”, dhe “kapter”, të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara për kualifikim.
 - b) **Komisionet e Zakonshme të Karrierës** janë përgjegjëse për shqyrtimin e ushtarakëve që plotësojnë kriteret ligjore për përparim në gradë dhe ndjekjen e kurseve të kualifikimeve që shërbejnë për marrjen e gradës së radhës, e përkatësisht:
 - i) Oficerët për marrjen e gradave “toger/lejtënant”, kapiten/kapitenlejtënant dhe për kualifikimin e personelit oficer nga grada “nëntoger/nënlejtënant” deri në gradën “toger/lejtënant”.
 - ii) Nënoficerët për marrjen e gradave “tetar” dhe “rreshter”, dhe për kualifikimin e personelit nënoficer nga grada “nëntetar” deri në gradën “tetar”.
3. Komisionet e karrierës e zhvillojnë veprimtarinë e tyre mbështetur në urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes, e përkatësisht:
- a) Komisioni i Lartë i Karrierës ngrihet dhe funksionon në ambjentet e Garnizonit “Skënderbej”.
 - b) Komisionet e Zakonshme të Karrierës ngrihen dhe funksionojnë përkatësisht në:
 - i) Komandat e forcave Tokësore, Detare, Ajrore;
 - ii) Akademinë e Forcave të Armatosura;
 - iii) Komandën Mbështetëse;
 - iv) Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Neni 6

Përbërja e komisioneve të karrierës dhe afatet

1. Komisionet që funksionojnë sipas kësaj rregulloreje përbëhen nga:

- a) Komisioni i Lartë i Karrierës:
 - i) një gjeneral major/nënadmiral, - kryetar
 - ii) tre gjeneralë brigade/kundëradmiralë, - anëtarë
 - iii) tre kolonelë/kapitenë të rangut i anëtarë.

Në rast mungese organike të oficerëve me gradën madhore “gjeneralmajor/nënadmiral”, ata zëvendësohen me oficerë me gradën madhore “gjeneral brigade/kundëradmiral”.

Në rastet kur shqyrtohen oficerë dhe nënoficerë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në komision marrin pjesë respektivisht edhe dy kolonelë kur shqyrtohen oficerët dhe dy kryekapterë kur shqyrtohen nënoficerët nga kjo Agjenci, me të drejtë vote.

Futja e dy anëtarëve të përkohshëm dhe largimi i dy anëtarëve të përhershëm përcaktohet në urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes “Për krijimin e komisioneve të karrierës”.

Në këtë rast numri i anëtarëve të komisionit të karrierës nuk ndryshon (mbetet shtatë), por dy anëtarët e tjerë, të cilët i bashkohen komisionit (oficerë ose nënoficerë) zëvendësojnë përkatësisht dy anëtarë të komisionit.



b) Komisioni i Zakonshëm i Karrierës:

i) një gjeneral brigade/kundëradmiral, - kryetar

ii) gjashtë kolonelë/kapitenë të rangut I-rë, - anëtarë

Në rast mungese organike të oficerëve me gradën madhore "gjeneral brigade/kundëradmiral", ata zëvendësohen me oficerë me gradën "kolonel/kapiten i rangut të parë" dhe në rast mungese organike të oficerëve me gradën "kolonel/kapiten i rangut të parë", ata zëvendësohen me oficerë me gradën "nënkolonel/kapiten i rangut të dytë".

Në rastet kur shqyrtohen nënoficerët për marrjen e gradave "tetar" dhe "rreshter", dhe për kualifikimin e personelit nënoficer nga grada "nëntetar" deri në gradën "tetar", kryetari i komisionit thërret për këshillim nënoficerin e forcës/komandës, i cili nuk ka të drejtë vote.

2. Komisionet mbledhen sipas afateve të përcaktuara në urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes, por në çdo rast, ato i përfundojnë procedurat e punës brenda:
 - a) muajit qershor të çdo viti, kur objekti i punës së tyre është vlerësimi i ushtarakëve për kualifikimet që shërbejnë për marrjen e gradës së radhës;
 - b) muajit tetor të çdo viti, kur objekti i punës së tyre është vlerësimi i përparimit në gradë të ushtarakëve.
3. Në ndihmë të komisioneve caktohet një sekretar. Përgjegjësitë e tij përcaktohen në këtë rregullore.

Neni 7

Detyrat e komisioneve

Detyrat e komisioneve janë:

1. të vlerësojë të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret ligjore për përparim në gradë dhe ndjekjen e kualifikimeve që shërbejnë për marrjen e gradës së radhës;
2. të shqyrtojë kandidatët më vete, sipas gradave në bazë force dhe specialiteti, sipas listave të përgatitura dhe vëna në dispozicion nga QPR-ja;
3. të respektojë parimet e ligjshmërisë, transparencës, informimit, mbrojtjes së sekretit shtetëror, të konfidencialitetit, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së ndihmës aktive, ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, drejtësisë, paanësisë e objektivitetit, përgjegjësisë, marrjes së vendimeve, barazisë dhe mosdiskriminimit, deburokratizimit dhe efijencës, mospagimit në procedurat administrative dhe parimit të kontrollit;
4. të sigurojë që të përzgjidhen për përparim në gradë dhe kualifikim ushtarakët më cilësorë në Forcat e Armatosura.

Neni 8

Përgjegjësitë e kryetarit të komisionit

Kryetari i komisionit ushtron këto përgjegjësi:

1. organizon mbledhjen e komisionit;
2. drejton diskutimet gjatë mbledhjeve të komisionit. Gjatë diskutimeve për vlerësim, kryetari i komisionit shprehet i fundit;
3. kërkon zbatimin e ligjit nr. 59/2014, datë 12.6.2014 "Për karrierën e ushtarakut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe të procedurave të kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore;



4. nënshkruan procesverbalet e mbledhjeve të komisionit, relacionin dhe listat e meritës së kandidatëve në përfundim të procesit të vlerësimit, pas nënshkrimit nga të gjithë anëtarët dhe sekretari;
5. kërkon informacion nga komandanti i Qendrës së Personel-Rekrutimit, për çdo sqarim, lidhur me dosjet elektronike ose fizike dhe listat e kandidatëve;
6. kërkon informacion nga komandanti i ASNI-së për gjendjen e Sistemit të Automatizuar të Burimeve Njerëzore, në funksion të veprimtarisë së komisioneve të karrierës;
7. përgjigjet për dërgimin në kohë të Ministri i Mbrojtjes, nëpërmjet SHSHP-së, të propozimeve për gradime, sipas listave të meritës të kandidatëve për gradime dhe kualifikime, shoqëruar me relacionin përkatës.

Neni 9

Përgjegjësitë e sekretarit të komisionit

Përgjegjësitë e sekretarit të komisionit janë:

1. siguron dokumentacionin për të gjithë kandidatët që do të vlerësohen nga komisioni;
2. mbështet komisionin me materiale të nevojshme për kryerjen e detyrës (kancelari, dosjet individuale elektronike, dosjet fizike apo të dhëna të tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e punës së komisionit);
3. siguron lajmërimin e të gjithë anëtarëve të komisionit për vendin, kohën dhe qëllimin e mbledhjes;
4. mban procesverbalin e mbledhjes së komisionit;
5. bën shpalljen e listave dhe merr masa për njoftimin e personelit për intervistë;
6. rakordon me QBO dhe strukturat e menaxhimit të personelit në reparte, për gjetjen e pikave të kontaktit (numër telefoni) të personelit që është jashtë vendit në kurse, përfaqësi, misione, trajnime etj, dhe përcakton datën dhe orën fikse të intervistës për këtë kategori personeli;
7. mban procesverbal për komunikimin me ushtarakët që ndodhen jashtë vendit, për zhvillimin e intervistës me ta, duke evidentuar; personin që kontaktohet, numrin e telefonit të tij, orën e kontaktimit, qëllimin dhe përgjigjet e ushtarakut, etj.
8. dërgon njoftimin individual për renditjen e të vlerësuarit nëpër forca e reparte;
9. evidenton në relacionin përfundimtar të gjitha problematikat e dala gjatë procesit të detajuar me emra për çdo rast.

Neni 10

Dokumentacioni i nevojshëm

Për përmbushjen e përgjegjësiave të tij, Komisioni i Karrierës mbështetet në dokumentacionin dhe të dhënat e mëposhtme:

1. listën e kandidatëve që u lind e drejta për përparimin në gradë dhe për kualifikimin e mëtejshëm;
2. dosjen individuale elektronike të personelit, e cila i dërgohet komisionit nga QPR-ja në rrugë elektronike për çdo kandidat. Kur kërkohet nga komisioni i dërgohet edhe dosja fizike;
3. dokumentacioni për vlerësimin e kandidatëve i paraqitet Komisionit të Karrierës, i skanuar nëpërmjet sistemit të automatizuar të të dhënave.

Neni 11

Mbështetja logjistike e komisioneve



Shtabi i Përgjithshëm i FA-së dhe Komandat e forcave/strukturave mbështetëse përgjigjen për krijimin e kushteve normale për punë dhe mbështetjen e komisioneve të karrierës me salla, kompjuterë, sistemin e automatizuar të të dhënave, internet, kancelari etj.

KREU III

ORGANET MBËSHTETËSE DHE PËRGJEGJËSITË E TYRE

Neni 12

Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve

Përgjigjet për:

1. përgatitjen e praktikave, sipas propozimeve të SHPFA-së, për miratimin e kuotave të gradimeve dhe miratimin e krijimit të komisioneve të karrierës;
2. vëzhgimin dhe kontrollin e procesit përgatitor, duke kontrolluar zbatimin e ligjit, të rregullores, të urdhrave, të udhëzimeve dhe kriteret përkatëse;
3. përgatitjen e urdhrave për Ministrin e Mbrojtjes për dhënien e gradave për oficerët;
4. përgatitje urdhrat e Ministrit të Mbrojtjes për fillimin e kurseve institucionale (KAO, KTHOSH, KKSHP dhe KLO), bazuar në listën e meritës dhe në propozimin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
5. përgatitjen e informacionit përmbledhës për Ministrin e Mbrojtjes mbi ecurinë e procesit të gradimeve;
6. bën rekomandime dhe propozime për përmirësimin e procedurave dhe kriterëve të vlerësimit, mbi bazën e mësimëve të nxjerra nga procesi i vlerësimeve;
7. në përfundim të procesit të vlerësimit dërgon në Drejtorinë e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm listat e meritës për ndjekjen e kurseve institucionale.

Neni 13

Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së (J-1)

Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së (J-1) përgjigjet për:

1. përgatitjen në emër të SHPFA-së, të praktikës për Ministrin e Mbrojtjes për miratimin e kuotave të gradimeve dhe krijimin e komisioneve të karrierës. Kuotat e gradimeve përcaktohen sipas udhëzimit të ministrit të Mbrojtjes, për procedurat dhe kriteret e përcaktimit të kuotave të gradimeve;
2. dërgimin në QPR dhe ASNI, të listës së personelit që në periudhën e testimeve ndodhen në detyra jashtë vendit, atashë, përfaqësi ushtarake, në misione, kurse të ndryshme, shtatzënë, me raport lindje/mjekësor, të shtruar në spital etj;
3. kërkon nga QPR-ja informacion për saktësinë e hedhjes së të dhënave në sistem, përgatitjen e listave të ushtarakëve që u lind e drejta për gradim dhe për ndjekjen e kurseve institucionale, përgatitjen e dosjeve individuale elektronike për çdo kandidat, njohjen e kandidatëve me dosjen individuale elektronike dhe marrjen e firmave;
4. përgatit projekt-urdhrat për SHSHP të FA-së për dhënien e gradave për personelin nënoficer;
5. bazuar në listën e meritës përgatit propozimin për Ministrin e Mbrojtjes, për fillimin e kurseve institucionale për personelin oficer;
6. bazuar në listën e meritës, përgatit projekt-urdhrat për SHSHP të FA-së për fillimin e kurseve institucionale për personelin nënoficer.

Neni 14

Akademia e Forcave të Armatosura



Akademia e Forcave të Armatosura përgjigjet për:

1. ekuivalentimin dhe konvertimin e kurseve institucionale për oficerët dhe nënoficerët që i kanë kryer ato jashtë vendit. Kjo detyrë duhet të kryhet brenda 5 ditëve nga marrja e dokumenteve të ushtarakëve dhe jo më vonë se data **20 Maj** për ushtarakët që do të shqyrtohen për ndjekjen e kurseve për kualifikim dhe **10 Shtator** për ushtarakët që do të shqyrtohen për përparim në gradë. Ekuivalentimi i kurseve të kryera jashtë vendit bëhet në bazë të urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes, të dalë për këtë qëllim;
2. caktimin e datave të testimit, marrjen e masave dhe zhvillimin e testeve në gjuhët e huaja (gjuhën angleze dhe gjuhët e tjera të vendeve të NATO-s), duke iu dhënë mundësinë e testimit të gjithë kandidatëve për gradim dhe kualifikim. Kjo detyrë duhet të realizohet gjatë muajve prill dhe korrik të çdo viti;
3. përcjelljen e rezultateve të testimit të gjuhëve të huaja pranë DMBNJSH-së në MM, Drejtorisë së Personelit në SHPFA-së dhe QPR-së;
4. ekuivalentimin dhe konvertimin e certifikatave të njohjes së gjuhëve të vendeve të tjera të NATO-s.

Neni 15

Strukturat e Forcave të Armatosura

Të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura përgjigjen për:

1. njohjen zyrtarisht kundrejt firmës, në kohën e duhur, të të gjithë kandidatëve që janë konkurentë për gradimin e radhës dhe kualifikimin përkatës, me:
 - a) të dhënat personale, dosjen individuale elektronike dhe plotësimin e mangësive 1 (një) muaj përpara mbledhjes së komisioneve të karrierës;
 - b) datat e zhvillimit të testeve në gjuhët e huaja;
 - c) datat e testimit në përgatitjen fizike;
 - ç) datën e ekzaminimit mjeksor në NJMU;
 - d) paraqitjen në intervista para komisionit të karrierës;
 - dh) vlerësimin e marrë nga komisionet e karrierës, sipas njoftimit që bëhen nga kryetarët e komisioneve të karrierës;
2. dërgimin në QPR të dokumentacionit të nevojshëm për ushtarakët që u lind e drejta për gradimin e radhës, si dhe të atyre që plotësojnë kushtet paraprake për kualifikimin e mëtejshëm. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara sipas origjinalit;
3. njoftimin dhe mbështetjen e ushtarakëve që kërkojnë të testohen në gjuhët e huaja, në datat e testimit që do të përcaktojnë QGJH-ja në AFA;
4. marrjen e masave për dërgimin e personelit kandidat për gradim dhe kualifikim pranë NJMU-së për kontrollin e gjendjes fiziko-shëndetësore. Kjo detyrë duhet të realizohet brenda muajit mars - prill për personelin që shqyrtohet për kualifikim dhe brenda muajit korrik - gusht për personelin që shqyrtohet për gradim, të çdo viti;
5. njohjen e ushtarakëve me rezultatet individuale që kanë arritur gjatë procesit të vlerësimit, shpalljen dhe publikimin e listave të vlerësimit të kandidatëve për gradim për forcën e tyre dhe ato për ndjekjen e kurseve institucionale;

Neni 16



Qendra e Personel-Rekrutimit

1. Qendra e Personel-Rekrutimit ka këto përgjegjësi:

- a) përgjigjet për administrimin e dokumentacionit dhe saktësinë e hedhjes së të dhënave në sistemin e automatizuar;
- b) mbështet komisionet me dokumentacionin e nevojshëm dhe sistemin e automatizuar të të dhënave;
- c) përgjigjet për përgatitjen e listave për kandidatët që u ka lindur e drejta për përparimin në gradë dhe për kualifikimin e mëtejshëm;
- ç) në listat e hartuara do të përfshihen ushtarakët që deri në datën 31 dhjetor plotësojnë kohën minimale të qëndrimit në gradë, moshën minimale të konkurrimit për marrjen e gradës së radhës, si dhe kriteret e tjera të përcaktuara nga ligji nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- d) i përcjellë AFA-së listat e personelit që do testohen në anglisht dhe në gjuhët e dyta.

2. Nuk përfshihen në listat për t'u shqyrtuar nga komisionet e karrierës ushtarakët që:

- a) janë vlerësuar tre herë nga komisionet;
- b) nuk plotësojnë moshën minimale të konkurrimit për marrjen e gradës së radhës, të përcaktuar nga neni 14/2 i ligjit 59/2014, i ndryshuar;
- c) kanë plotësuar moshën maksimale të qëndrimit në shërbim, deri në datën **01 Qershor** për personelin që shqyrtohet për kualifikimin e rradhës, dhe në datën **01 Tetor** për personelin që shqyrtohet për marrjen e gradës së rradhës, sipas nenit 14 dhe 14/1, të ligjit 59/2014, të ndryshuar, pavarësisht se nuk janë vlerësuar tri herë nga komisionet e karrierës.
- d) ç) janë deklaruar të paaftë nga ana shëndetësore nga komisioni mjekoligjor;
- e) janë pezulluar nga detyra për shkaqet e përcaktuara nga neni 24, pika 2, e ligjit 59/2014 "Për karrierën ushtarake në FA", i ndryshuar;
- dh) nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në lidhjet 1, 2, 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje.

- 3. Listat hartohen në përputhje me pikën 8, të udhëzimit të Ministrit të Mbrojtjes nr.04, datë 31.03.2016 "Për procedurat dhe kriteret e përcaktimit të kuotave të gradimeve".
- 4. Në bazë të listave të meritës, të dërguar nga AFA-ja, për çdo kurs institucional të kryer brenda vendit dhe rezultateve të kursantëve që kanë mbaruar studimet jashtë shtetit, QPR-ja përgatit listat e oficerëve dhe nënoficerëve që plotësojnë kushtet për t'u vlerësuar nga komisioni për ndjekjen e kurseve të ardhshme institucionale. Në listën e meritës përfshihen të gjithë kandidatët që kanë përfunduar kursin institucional të kërkuar, brenda ose jashtë vendit, pavarësisht notës mesatare të arritur.
- 5. Afati përfundimtar i pranimi të dokumenteve nga QPR për komisionet e karrierës, si: diploma, dëshmi, çertifikata, listë notash etj, është deri më **20 maj** për personelin që shqyrtohet për kualifikimin e rradhës, dhe jo më vonë se data **20 shtator** për personelin që shqyrtohet për gradimin e rradhës. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara sipas origjinalit.
- 6. QPR-ja në përfundim të hedhjes së të dhënave në sistemin e automatizuar përgatit Dosjen Individuale Elektronike (DIE) për çdo kandidat, që i ka lindur e drejta për t'u shqyrtuar për përparim në gradë dhe për kualifikim, si dhe njeh kandidatët me përmbajtjen e saj.
- 7. QPR-ja vë në dispozicion të komisioneve, dokumente shtesë, kur kërkohen nga ana e tyre.
- 8. Me mbylljen e procesit të gradimeve, në bazë të urdhrave të Ministrit të Mbrojtjes për dhënie të gradave, QPR-ja hedh të dhënat në Sistemin e Automatizuar të Burimeve Njerëzore.



Neni 17
Qendra e Automatizimit në ASNI

Qendra e Automatizimit në ASNI, ka këto përgjegjësi:

1. përgjigjet për implementimin e rregullores së komisioneve të karrierës në SIMBM;
2. përgatit "Manualin e Përdorimit të Sistemit të Votimit Elektronik" dhe e afishon online në modulën e KK-së për gjithë anëtarët e komisioneve;
3. bën kalimin e bazës së të dhënave nga moduli i burimeve njerëzore në modulën e komisioneve të karrierës, pas përfundimit të hedhjes së të dhënave për personelin për gradim/kualifikim nga ana e QPR-së dhe strukturave të Forcave të Armatosura (1 ditë para fillimit të punës së komisioneve, përcaktuar në urdhrin e MM-së);
4. bën mbështetjen nga ana teknike të komisioneve të karrierës, user name (emri i përdoruesit), password (fjalëkalimin), IP etj., dhe suportin teknik gjatë gjithë procesit;
5. bën azhurnimin e të dhënave të shtuara në sistem, për çdo parregullsi të konstatuar gjatë procesit të vlerësimit, për rubrika të paplotësuara ose të plotësuara gabim nga ana e QPR-së (renditja gabim e vlerësimeve vjetore, mospërzgjedhje e detyrave funksionale etj.), të cilat ndikojnë në mosmbylljen e procesit të votimit, sipas urdhrin të kryetarit të komisionit përkatës dhe pas rregullimit nga QPR-ja;
6. siguron dhe garanton mbështetjen teknike në çdo moment për mirëfunksionimin e këtij procesi.

KREU IV

VLERËSIMI I USHTARAKËVE PËR PËRPARIMIN NË GRADË

Neni 18

Treguesit dhe kriteret e vlerësimit për përparimin në gradë të oficerëve dhe nënoficerëve

Komisionet e karrierës për vlerësimin e oficerëve dhe nënoficerëve për përparimin në gradë përdorin treguesit dhe kriteret e dhëna në lidhjen 1 dhe lidhjen 2, të kësaj rregulloreje.

Neni 19

Procedurat e punës dhe funksionimit të komisioneve të karrierës

Për ushtrimin e përgjegjësiave të tyre komisionet e karrierës zbatojnë procedurën e mëposhtme:

1. komisionet e karrierës, para ushtrimit të veprimtarisë së tyre, duhet të njihen me urdhrin e ministrit për krijimin e komisionit përkatës, me "Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e komisioneve të karrierës", me ligjin nr. 59/2014, datë 12.6.2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe duhet të familjarizohen me procedurat, me metodologjinë e vlerësimit dhe mënyrën e përdorimit të sistemit elektronik të votimit;
2. komisionet njihen me listat e kandidatëve për gradim, listat e kandidatëve për arsimim/kualifikim, dosjet individuale elektronike të kandidatëve, dosjet fizike, kur është e nevojshme, si dhe me "Manualin e Përdorimit të Sistemit të Votimit Elektronik";
3. para fillimit të punës, kryetari i komisionit të karrierës organizon hedhjen e një shorti, me qëllim që çdo anëtar i komisionit të ketë një numër kodik për ruajtjen e konfidencialitetit dhe anonimitetit;
4. anëtarët e komisionit njihen me dosjet individuale elektronike të kandidatëve, sipas rendit alfabetik. Ata shqyrtojnë në mënyrë të pavarur dosjet dhe të dhënat e automatizuara të secilit kandidat dhe mbajnë shënimet përkatëse të nevojshme për kryerjen e vlerësimit;



5. me përfundimin e studimit të të gjitha dosjeve, nën drejtimin e kryetarit të komisionit, anëtarët e komisionit fillojnë procedurën e vlerësimit të secilit kandidat në bazë të të dhënave të dosjes individuale elektronike. Çdo anëtar i komisionit, individualisht pa u konsultuar me anëtarët e tjerë të komisionit, për çdo kandidat, vendos pikët në kompjuterin personal të caktuar për këtë qëllim;
6. kryetari i komisionit, në përfundim të vlerësimeve të bëra individualisht nga secili anëtar i komisionit, verifikon nëpërmjet kompjuterit qendror të sekretarit të komisionit, kryerjen e votimit nga secili anëtar. Në rast se diferencat maksimum/minimum midis anëtarëve janë më të mëdha sesa parashikohet në këtë rregullore, atëherë kryetari i komisionit kërkon përsëritjen e vlerësimit;
7. vlerësimi me pikë do të llogaritet deri në tre shifra pas presjes dhjetore;
8. komisionet e karrierës në përfundim të vlerësimit përgatisin listat e meritës, sipas specifikimeve të bëra në pikën 8, të udhëzimit të ministrit të Mbrojtjes nr.04, datë 31.03.2016 "Për procedurat dhe kriteret e përcaktimit të kuotave të gradimeve";
9. listat e meritës të kandidatëve të vlerësuar nënshkruhen nga kryetari dhe nga çdo anëtar i komisionit të karrierës. Në qoftë se ndonjë nga anëtarët e komisionit nuk pajtohet me vlerësimin e ndonjë pike të rubrikave, ai shpreh me shkrim vlerësimin e tij;
10. në përfundim të procesit, komisionet e karrierës i dërgojnë Ministrit të Mbrojtjes, nëpërmjet shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së relacionin përmbledhës mbi veprimtarinë e komisionit, si dhe listë meritën e kandidatëve të vlerësuar për përparim në gradë, si dhe për ndjekjen e kurseve institucionale për vitin e ardhshëm akademik;
11. në përfundim të punës së Komisionit të Karrierës, kryetari i komisionit njofton me shkrim komandat dhe çdo individ për pikët që kanë marrë ushtarakët e tyre gjatë procesit të vlerësimit. Njoftimi bëhet sipas formatit bashkëlidhur, lidhja 5. Ky njoftim konsiderohet paraprak, pasi renditja përfundimtare e ushtarakëve mbyllet me shqyrtimin e ankesave nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave. Njoftimi bëhet i detajuar për çdo rubrikë të vlerësuar, duke treguar edhe renditjen e ushtarakut në listën e meritës;
12. kandidatët, në rast se nuk janë dakord me vlerësimin e bërë nga komisioni, kanë të drejtë të ankohen te Ministri i Mbrojtjes, sipas përcaktimeve të nenit 28, të ligjit nr. 59/2014, datë 12.6.2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
13. pas përfundimit të afatit ligjor të procesit të ankimit nga ana e kandidatëve, si dhe pas përfundimit të procesit të shqyrtimit të ankesave nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, DMBNJSH, nëpërmjet Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, i paraqet Ministrit të Mbrojtjes një informacion përfundimtar në lidhje me procesin e gradimeve;
14. gradimet bëhen pas përfundimit të procedurave të shqyrtimit të ankesave nga komisioni përkatës, sipas nenit 29, të ligjit nr.59/2014, datë 12.6.2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 20

Garantimi i transparencës, objektivitetit dhe paanësisë së Komisionit të Lartë të Karrierës

1. Me qëllim zhvillimin e një procedure transparente konkurrimi, si dhe duke synuar ruajtjen e objektivitetit dhe paanësisë së Komisionit të Lartë të Karrierës, procesi i intervistës me pyetje të këtij komisioni, do të regjistrohet me video dhe audio.
2. Kryetari i KKK-së ka për detyrë të informojë anëtarët e komisionit, si dhe kandidatët që do të merren në pyetje për incizimin e të gjithë procedurës.



3. Rregjistrimi përbën informacion të kufizuar dhe trajtohet sipas rregullave në fuqi për këtë çështje.
4. Të drejtën për t'u njohur me përmbajtjen e këtij rregjistrimi e ka:
 - a) kandidati i vlerësuar vetëm për pjesën e tij, kur bën ankim në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave;
 - b) Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vetëm për pjesën e të ankuarit;
 - c) dhe ministri i Mbrojtjes për të gjithë procedurën.
5. Rregjistrimi administrohet bashkë me të gjithë dosjen e punimeve të KLK-së në Sekretarinë e Shtabit të Përgjithshëm të FA. Dhënia e aksesit për njohje me pjesët përkatëse, sipas pikës 4 të këtij neni bëhet nëpërmjet ASNI-së.
6. Gjatë gjithë zhvillimit të procedurës Ministrit i Mbrojtjes cakton me urdhër 3 (tre) persona civil nga ministria e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura, ose strukturat e tyre të varësisë, të cilët marrin pjesë në zhvillimin e punimeve të KLK-së në cilësinë e vëzhgueseve. Përfshihen nga kjo e drejtë stafi politik i ministrit të Mbrojtjes dhe AISM.
7. Vëzhguesit në përfundim të punimeve të KLK-së raportojnë me shkrim te Ministri i Mbrojtjes në lidhje me mbarëvajtjen e punimeve të KLK-së.
8. Vëzhguesve u ndalohej të ndërhyjnë apo të marrin pjesë aktivisht në çfarë do lloj forme në punimet e KLK-së.

Neni 21

Elementet e vlerësimit dhe pesha specifike e tyre

1. Për vlerësimin e kandidatëve do të përdoret sistemi 100 pikësh, të cilat ndahen në pikët administrative dhe pikët e komisionit të karrierës.
2. Pikët e siguruar nga vlerësimi i elementeve të përcaktuara në germën "a", "b", "c", "ç", "d" dhe "dh", të pikës 4 të këtij neni, konsiderohen pikë administrative.
3. Pikët e siguruar nga vlerësimi i elementeve të përcaktuara në germën "e", "ë", dhe "f", të pikës 4 të këtij neni, janë pikët e komisionit të karrierës.
4. Elementet e vlerësimit janë, si më poshtë:
 - a) Kursi institucional (KI);
Për personelin oficer dhe nënoficer (OF-4 dhe OR-8), sipas pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr.59/2014 datë 12.6.2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, që shqyrtohet për kualifikim, vlerësimi bëhet sipas tabelës nr.5 neni 31 dhe tabelës nr.6, neni 32 në këtë rregullore.
 - b) Arsimi lartë (AL), (vetëm për personelin nënoficer);
 - c) Gjuha angleze (GJH);
 - ç) Gjuhët e huaja të tjera (GJHT);
 - d) Testimi fizik (TF);
 - dh) Medaljet dhe Dekoratat (M&D);
 - e) Vlerësim i performancës gjatë kohës së qëndrimit në gradë (VPerf.);
 - ë) Detyrat funksionale të kryera gjatë kohës së qëndrimit në gradë (DF);
 - f) Intervista (I).
5. Peshat specifike e faktorëve të vlerësimit përcaktohet në varësi të kategorisë së ushtarakëve dhe gradave, sipas tabelës 1.



Neni 22

Llogaritja e pikëve administrative

1. Pikët administrative (PA) sigurohen nga vlerësimi i:

a) Kursit institucional (KI);

Për personelin oficer dhe nënoficer (OF-4 dhe OR-8), sipas pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr.59/2014 datë 12.6.2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, që shqyrtohet për kualifikim, vlerësimi bëhet sipas tabelës nr.5 neni 31 dhe tabelës nr.6, neni 32 në këtë rregullore.

b) Arsimit të lartë (AL);

c) Gjuhës angleze;

ç) Gjuhëve të tjera të huaja;

d) Rezultateve të testimit fizik;

dh) Medaljeve dhe dekoratave.

2. Sasia maksimale e pikëve administrative është e ndryshme për kategori të ndryshme ushtarakësh dhe grada të ndryshme, sipas tabelës 1.

Treguesit e vlerësimit dhe sasia e pikëve për promovimin e oficerëve dhe nënoficerëve

Tabela 1

Nr.	Treguesit e vlerësimit	Sasia e pikëve për promovim					
		Oficerët			Nënoficerët		
		OFO OF1	OF2 OF4	Specialitete OF4	OR5 OR6	OR7 OR8	Specialitete OR8
Pikët administrative							
1	Kursi institucional	26	26	-	22	22	-
2	Arsimi i lartë			26	4	4	26
3	Gjuha angleze	8	10	10	8	10	10
4	Gjuhët e tjera të huaja	2	2	2	2	2	2
5	Testimi fizik	8	6	6	8	6	6
6	Medaljet dhe dekoratat	2	2	2	2	2	2
	Shuma e pikëve	46	46	46	46	46	46
Pikët e Komisioneve të Karrierës							
1	Vlerësimi i performancës	36	36	36	36	36	36
2	Vlerësimi i detyrave funksionale	10	10	10	10	10	10
3	Intervista		8			8	
	Shuma e pikëve	46	54	54	46	54	54
	Shuma e përgjithshme	92	100	92	92	100	92

3. QPR-ja është përgjegjëse për llogaritjen e pikëve administrative dhe hedhjen e tyre në Sistemin e Automatizuar të Burimeve Njerëzore (SABNJ), në bazë të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në këtë rregullore. Llogaritja dhe hedhja e tyre në sistem bëhet rast pas rasti.



4. Për vlerësimin e oficerëve nëntoger deri në nënkolonel (OF0-OF4) të specialiteteve të përcaktuara nga VKM përkatëse që nuk kanë kursin institucional, aplikohen treguesit sipas tabelës 5. Për vlerësimin e nënoficerëve, që mbajnë gradën nëntetar deri kapter (OR5-OR8) të specialiteteve të përcaktuara nga VKM përkatëse që nuk kanë kursin institucional, aplikohen treguesit sipas tabelës 6.
5. Për vlerësimin e oficerëve nënkolonel (OF4) të specialiteteve të përcaktuara nga VKM përkatëse dhe për vlerësimin e nënoficerëve që mbajnë gradën kapter (OR8) të specialiteteve të përcaktuara nga VKM përkatëse, për kualifikimin e radhës, aplikohen treguesit sipas tabelës 1 kolona (Specialitete).
6. Ushtarakët e specialiteteve, do të vlerësohen për përparimin në gradë sipas nenit 21 të ligjit 59/2014, i ndryshuar, vetëm në rast se ushtrojnë specialitetin përkatës sipas funksionit organik dhe e kanë të njohur dhe të pasqyruar në sistem.

Neni 23

Vlerësimi i kursit institucional ushtarak (VKI)

1. Vlerësimi i kursit Institucional mbështetet në notën mesatare (N.mes.) të përfundimit të kursit institucional të nevojshëm për marrjen e gradës së radhës, të njohur me dokument zyrtar;
2. Vlerësimi i Arsimit të Lartë (AL), për personelin oficer me gradën Nënkolonel (OF4), sipas pikës 4, të nenit 2, të ligjit 59/2014, i ndryshuar, mbështetet në notën mesatare (N.mes.) të përfundimit të shkollës të nevojshëm për ndjekjen e kursin e radhës.
3. Vlerësimi i Arsimit të Lartë (AL) dhe të mesëm për personelin nënoficer me gradën Kapter (OR8), sipas pikës 4, të nenit 2, të ligjit 59/2014, i ndryshuar, mbështetet në notën mesatare (N.mes.) të përfundimit të shkollës të nevojshëm për ndjekjen e kursin e radhës.
4. Pesha (P) që ze vlerësimi i kursit institucional në vlerësimin e përgjithshëm të ushtarakut përcaktohet në tabelën 1 të kësaj rregulloreje;
5. Llogaritja e pikëve të siguruara për kursin institucional bëhet sipas formulës:

$$VKIU = P \times N \text{ mes. } / 10$$

6. Në rast se ushtaraku ka kryer më shumë se një kurs institucional ose ka bërë dy kurse të të njëjtit nivel, nga ana e QPR-së, për efekt llogaritje për vlerësim, do të merret parasysh kursi institucional me rezultatin më të lartë. Kur ushtaraku ka kryer një kurs institucional të një niveli më të lartë se niveli i kërkuar për promovim, atëherë merret për bazë kursi institucional që kërkohet për përparimin në gradë.

Neni 24

Vlerësimi i arsimit të lartë civil (VAL)

1. Ky tregues vlerësimi aplikohet vetëm gjatë vlerësimit të nënoficerëve. Pesha specifike e këtij treguesi është 4 pikë.
2. Në vlerësimin e diplomës së arsimit të lartë merret parasysh vetëm dokumenti zyrtar që vërteton kryerjen e tij, i shoqëruar me listën e notave.
3. Sasia e pikëve për diplomën e arsimit të lartë llogaritet mbi bazën e notës mesatare të diplomës, sipas formulës:

$$VDAL = P \times N \text{ mes. no}$$



Neni 25

Vlerësimi i aftësive në gjuhët e huaja (VGJH)

1. Vlerësimi i aftësive në gjuhët e huaja përbëhet nga dy komponentë: vlerësimi i njohurive të gjuhës angleze (VGJA) dhe vlerësimi i njohurive të gjuhëve të tjera të vendeve të NATO-s (VGJHT).
2. Vlerësimi mbështetet në testimet e kryera nga ushtaraku për aftësimin në njohjen dhe përdorimin e gjuhëve të huaja, si: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, turqisht, spanjisht, si dhe të gjuhëve të tjera që mësohen e përdoren në funksion të nevojave të bashkëpunimit me aleatët tanë të NATO-s.
3. Pësia që zë vlerësimi i gjuhëve të huaja në vlerësimin e përgjithshëm varet nga kategoria të cilës i përket ushtarakët dhe grada (tabela 1).
4. Në vlerësimin e aftësive në gjuhën e huaj merret parasysh niveli i njohjes dhe përdorimit të saj, sipas STANAG-6001 ose ALCPT/ ELPT-së, të vërtetuar me dokument zyrtar. Rezultatet e vlerësimit sipas STANAG-6001, janë të vlefshme për të gjitha gjuhët për një afat 2 (dy) vjet nga data e dhënies së testit. Testimi sipas ALCPT/ ELPT-së është i vlefshëm për 105 ditë nga data e dhënies së testit. Vlefshmëria e rezultateve të testimit, për efekt vlerësimi nga Komisioni i Karrierës është data **20 maj** për personelin që shqyrtohet për kualifikimin e rradhës, dhe jo më vonë se data **20 shtator** për personelin që shqyrtohet për marrjen e gradës së rradhës.
5. Kur autoritetet përkatëse kërkojnë testimin e kandidatëve në gjuhën angleze dhe gjuhët e tjera të huaja llogaritja e pikëve do të bëhet mbi bazën e rezultatit të arritur në testimin e kryer. Në këtë rast testimi duhet të kryhet jo më vonë se data 20 Maj për personelin që shqyrtohet për kualifikimin e rradhës, dhe jo më vonë se data 20 shtator për personelin që shqyrtohet për marrjen e gradës së rradhës. Ushtarakët që nuk marrin pjesë në testim për arsye objektive, i jepet mundësia e një rritimi dhe në rast të mos realizimit të përsëritjes së testimit pavarësisht shkakut, vlerësohen me "0" zero pikë.
6. Vlefshmëria e rezultateve të testimit skadon në datën e skadimit të afateve të përcaktuara në pikën 4. Në rast se vlefshmëria e gjuhëve të huaja skadon, ndërkohë që ushtaraku është jashtë vendit në detyra të ndryshme, në komandat apo shtabet e NATO-s, atëherë, në misione ose kurse afatgjata, vlefshmëria e gjuhëve të huaja për efekt vlerësimi, për këtë kategori ushtarakësh, shtyhet deri në datën 30 maj për personelin që shqyrtohet për kualifikimin e rradhës dhe deri në datën 30 shtator për personelin që shqyrtohet për marrjen e gradës së rradhës, por me kusht që testimi i fundit i tyre të mos jetë më shumë se 4 (katër) vjet nga data 01 qershor për personelin që shqyrtohet për kualifikimin e rradhës dhe nga data 01 tetor për personelin që shqyrtohet për gradim. Në rast të kundërt ushtarakët duhet të marrin masa që të testohen dhe të administrojnë në sistem një testim të vlefshëm.
7. Në çdo rast, vlerësimi për aftësitë e gjuhës së huaj do të bëhet mbi bazën e rezultatit të arritur në testimin e fundit në QGJH. Konvertimet apo vlerësimet e bëra jashtë këtij rregulli konsiderohen të pavlefshme.

Neni 26

Vlerësimi i aftësive në gjuhën angleze (VGJA)

1. Niveli i gjuhës angleze është një komponent i rëndësishëm për përparimin në gradë të ushtarakëve.
2. Pësia e vlerësimit të saj është e ndryshme dhe varet nga kategoritë dhe gradat e ushtarakëve (tabela 1). Nivelet e aftësive në gjuhën angleze sipas STANAG - 6001 dhe ELPT/ALCPT-së vlerësohen me notë (N), sipas tabelës 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje.



3. Përlllogaritja e pikëve të përfituara nga ushtaraku në njohjen dhe përdorimin e gjuhës angleze, sipas STANAG — 6001 dhe ELPT/ALCPT-së), bëhet sipas formulës:

$$VGJA \times P \times N/IO$$

4. Për çdo vlerësim plus "+" të marrë gjatë testimit të gjuhës angleze, sipas STANAG-ut 6001, ushtaraku vlerësohet me plus 0.15 pikë.
5. Llogaritja e pikëve për çdo vlerësim plus "+" bëhet sipas formulës:

$$VGJA - \frac{x \times N}{101 + v_1 + \dots + v_4}, \text{ ku;}$$

P-pesha që zë vlerësimi i gjuhës angleze në vlerësimin e përgjithshëm. VI ... V4, është vlera në pikë për çdo plus "-F".

6. Për personelin oficer me gradat OF2-OF4 dhe personelin nënoficer me gradat OR7-OR8, vlerësimi i gjuhës angleze do të jetë sipas tabelës nr.2.

Tabela 2

Nr.	Niveli i gjuhës sipas STANAG-ut 6001 dhe afati i vlefshmërisë. 2 vjet	Niveli i gjuhës sipas ALCPT/ELPT-së dhe afati i vlefshmërisë. 105 ditë	Nota	Vlerësimi me pikë				
				Vlerësimi me pikë për nivelin sipas STANAG 6001/ALCPT	Niveli me një "+"	Niveli me dy "+"	Niveli me tre "+"	Niveli me katër "+"
					V1	V2	V3	V4
1	3333	91-100	10	10				
2	3332	86-90	9	9	9.15			
3	3322	81-85	8	8	8.15	8.30		
4	3222	76-80	7	7	7.15	7.30	7.45	
5	2222	71-75	6	6	6.15	6.30	6.45	6.60
6	2221	66-70	5	5	5.15	5.30	5.45	5.60
7	2211	61-65	4	4	4.15	4.30	4.45	4.60
8	2111	56-60	3	3	3.15	3.30	3.45	3.60
9	1111	51-55	2	2	2.15	2.30	2.45	2.60
10	1110	46-50	1	1	1.15	1.30	1.45	1.60

7. Për personelin oficer me gradat OF0-OF1 dhe personelin nënoficer me gradat OR5-OR6, vlerësimi i gjuhës angleze do të jetë sipas tabelës nr.3.

Tabela 3

Nr.	Niveli i gjuhës sipas STANAG-ut 6001 dhe afati i vlefshmërisë. 2 vjet	Niveli i gjuhës sipas ALCPT/ELPT-së dhe afati i vlefshmërisë. 105 ditë	Nota	Vlerësimi me pikë				
				Vlerësimi me pikë për nivelin sipas STANAG 6001/ALCPT/ELPT-së	Niveli me një "+"	Niveli me dy "+"	Niveli me tre "+"	Niveli me katër "+"
					V1	V2	V3	V4
1	3333	91-100	10	8				
2	3332	86-90	9	7.2	7.35			
3	3322	81-85	8	6.4	6.55	6.7		
4	3222	76-80	7	5.6	5.75	5.90	6.05	
5	2222	71-75	6	4.8	4.95	5.10	5.25	5.40
6	2221	66-70	5	4	4.15	4.30	4.45	4.60
7	2211	61-65	4	3.2	3.35	3.50	3.65	3.80
8	2111	56-60	3	2.4	2.55	2.70	2.85	3
9	1111	51-55	2	1.6	1.75	1.90	2.05	2.20
10	1110	46-50	1	0.8	0.95	1.10	1.25	1.40



Neni 27

Vlerësimi i gjuhëve të huaja të vendeve të tjera të NATO-s (VGJHT)

1. Bazë për vlerësimin e njohurive në gjuhët e tjera është testimi. AFA-ja (Departamenti i Gjuhëve të Huaja) është përgjegjëse për zhvillimin e testimit dhe vlerësimin e njohurive, si dhe konvertimin me notë të certifikatave/diplomave të gjuhëve të tjera të vendeve të NATO-s. Gjuhët e dyta që janë vlerësuar sipas STANAG-ut 6001, të konvertohen me notë nga QPR-ja, duke përdorur tabelën 2.
2. Për ushtarakët që zotërojnë dy e më shumë gjuhë të dyta të vendeve të NATO-s, për efekt vlerësimi do të merret në konsideratë gjuha e huaj që ushtaraku ka nivelin më të lartë të njohjes.
3. Peshë që ka vlerësimi i gjuhëve të huaja të tjera në vlerësimin e përgjithshëm përcaktohet në tabelën 1.
4. Vlerësimi i aftësive në njohjen dhe përdorimin e gjuhëve të tjera të vendeve të NATO-s bëhet sipas formulës:

$$VGJHT = P \times N \text{ no}$$

5. Përlllogaritja e pikëve totale të përfituara nga ushtarakët në njohjen dhe përdorimin e gjuhëve të huaja bëhet sipas formulës:

$$VGJH = VGJA + VGJHT$$

Neni 28

Vlerësimi i aftësive fizike (VAF)

1. Vlerësimi i aftësive fizike bazohet në rezultatet e arritura gjatë testimit fizik, i cili zhvillohet sipas "Rregullores së Testit Ushtarak të Përgatitjes Fizike", të miratuar me urdhër të autoritetit përkatës.
2. Vlerësimi për aftësitë fizike (VAF) bëhet në bazë të notës që ka marrë çdo kandidat gjatë TUPF, sipas tabelës 4.
3. Testimi i përgatitjes fizike ushtarake (TUPF) zhvillohet 2 (dy) herë në vit, si rregull në muajin prill dhe tetor. Për efekt vlerësimi nga Komisioni i Karrierës do të merren parasysh rezultatet e testimit të fundit, të vitit gjatë të cilit mbledhen komisionet e karrierës. Strukturat përgjegjëse në MM/SHP/forca/komandat mbështetëse/njësitë dhe repartet, hedhin të dhënat e testimit fizik dhe ekzaminimit shëndetësor në sistemin e automatizuar të të dhënave.
4. Për ushtaraket femra shtatzënë apo me leje lindje, si dhe për ushtarakët e shtruar në spital, të vërtetuar me raport mjekoligjor nga Njësia Mjekësore Ushtarake, nëse testimi nuk kryhet deri në datën 20 maj për personelin që shqyrtohet për kualifikimin e rradhës, dhe deri në datën 20 shtator për personelin që shqyrtohet për marrjen e gradës së rradhës, për shkak të vazhdimit të paafësisë, për efekt vlerësimi do të merren parasysh rezultatet e testimit të fundit.
5. Për ushtarakët që janë jashtë vendit në misione, kurse të ndryshme afatgjatë ose me detyra në shtabet e NATO-s dhe atashetë ushtarakë për efekt vlerësimi nga komisionet e karrierës do të merren parasysh rezultatet e testimit të fundit, që ata kanë në sistem, por jo më larg se 3 vjet nga data 01 qershor për ushtarakët që do të shqyrtohen për ndjekjen e kurseve për kualifikim dhe data 01 tetor për ushtarakët që do të shqyrtohen për përparim në gradë.
6. Kur autoritetet përkatëse kërkojnë testimin fizik të kandidatëve llogaritja e pikëve do të bëhet mbi bazën e rezultatit të arritur në testimin e kryer. Në këtë rast testimi duhet të kryhet deri në datën 20 maj për personelin që shqyrtohet për kualifikimin e rradhës, dhe deri në datën 20



shtator për personelin që shqyrtohet për marrjen e gradës së rradhës. Ushtarakët që nuk marin pjesë në testim për arsye objektive, i jepet mundësia e një ritestimi, në rast të mos realizimit të përsëritjes së testimit pavarësisht shkakut vlerësohen me "0" zero pikë.

Tabela 4

Tabela e sasisë së pikëve të testimit fizik të vlefshme për promovim.

Rezultati (nota) i arritur gjatë TUPF	Sasia e pikëve për promovim					
	Oficerë			Nënoficerë		
	OFO-OF1	OF2-OF4		OR5-OR6	OR7-OR8	
10	8	6		8	6	
9	6.5	5		6.5	5	
8	5	4		5	4	
7	3.5	3		3.5	3	
6	2	2		2	2	
5	1	1		1	1	

Neni 29

Vlerësimi i medaljeve dhe dekoratave (VM&D)

1. Vlerësimi i medaljeve dhe dekoratave përfaqëson një vlerë të spikatur në vlerësimin e meritave të çdo ushtaraku në karrierën e tij.
2. Peshë që ka vlerësimi i medaljeve dhe dekoratave në vlerësimin e përgjithshëm përcaktohet në tabelën 1.
3. QPR-ja është përgjegjëse për evidentimin e tyre në rekordet e personelit, llogaritjen dhe hedhjen e pikëve në dosjen elektronike, sipas modaliteteve që përcaktohen në këtë nen.
4. Medaljet dhe dekoratat janë të vlefshme vetëm në bazë të dekretit të Presidentit ose urdhrat të autoritetit që e ka dhënë.
5. Llogaritja e pikëve bëhet sipas rregullit të mëposhtëm:
 - a) për çdo dekoratë të dhënë nga Presidenti i Republikës, ushtaraku vlerësohet me 0.6 pikë;
 - b) për çdo medalje të dhënë nga Ministri i Mbrojtjes, ushtaraku vlerësohet me 0.5 pikë;
 - c) për çdo medalje të dhënë nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, ushtaraku vlerësohet me 0.4 pikë;
 - ç) për çdo medalje të dhënë nga autoritetet ndërkombëtare (përfaqësues të lartë të NATO, OKB, OSBE, komandanti i strukturës së misionit) ushtaraku vlerësohet me 0.4 pikë;
 - d) për çdo medalje të dhënë nga komandantët e Forcave, ushtaraku vlerësohet me 0.3 pikë;
 - dh) për çdo medalje të dhënë nga nivelet e tjera të komandimit, ushtaraku vlerësohet me 0.2 pikë;
 - ë) medaljet e karrierës nuk vlerësohen me pikë.
6. Shuma e pikëve llogaritet sipas formulës:

$$VM\&D = VM + VD, \text{ ku:}$$

- VM&D - shuma e pikëve të përfuara nga vlerësimi i medaljeve dhe dekoratave;
- VM - shuma e pikëve të përfuara nga vlerësimi medaljeve;
- VD - shuma e pikëve të përfuara nga vlerësimi i dekoratave.



7. Kur pikët e përfituara nga vlerësimi i dekoratave dhe medaljeve është më tepër se sa është parashikuar në tabelën 1, ushtaraku vlerësohet vetëm me pikët maksimale që i korrespondojnë kategorisë dhe gradave të ushtarakëve.

Neni 30

Sasia e përgjithshme e pikëve administrative

1. Sasia e përgjithshme e pikëve administrative llogaritet sipas formulës:

$$PA=VKI+VAL+VGJA+VGJHT+VTF+VM\&D$$

Neni 31

Vlerësimi i arsimit dhe kualifikimit të oficerëve të specialiteteve që mbajnë gradën OF0-OF4

- Vlerësimi i kësaj kategorie të oficerëve bëhet duke pasur parasysh kërkesat e nenit 21, pika 1, të ligjit nr. 59, datë 12.06.2014 "Për karrierën e ushtarakut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe nevojat organike. Vlerësimi i pikëve administrative për oficerët e specialiteteve, përveç treguesve të nenit 24, 25, 26, 27, dhe 28 të kësaj rregulloreje përfshin edhe vlerësimin e diplomave e kurseve të marra/kryera gjatë kohës së qëndrimit në gradë, si më poshtë:
 - vlerësimin e arsimit të lartë në fushën e specialitetit (bachelor, master);
 - vlerësimin e specializimit të plotë pasuniversitar (e vlefshme për oficerët e mjekësisë);
 - vlerësimin e kurseve funksionale në fushën e specialitetit, të kryera gjatë kohës së qëndrimit në gradë;
 - vlerësimin e kursit institucional kur e ka kryer.
- Treguesit e vlerësimit dhe sasia e pikëve përcaktohen në tabelën 5.

Tabela 5

	Treguesit e vlerësimit	Sasia e pikëve	Kohëzgjatja e kursit
Pikët administrative			
1	Arsimi i lartë në fushën e specialitetit (Master profesional, Master shkencor) / Specializimi afatgjatë (në fushën e mjekësisë)	10	
2	Kurset afatshkurtra (brenda kohës së qëndrimit në gradë)	2	> 1-3 muaj
3	Kurset afatmesme (brenda kohës së qëndrimit në gradë)	4	>3-6 muaj
4	Kurset afatgjata (brenda kohës së qëndrimit në gradë)	6	>6 muaj-2 vjet
5	Kursi institucional	4	

3. Arsimi i lartë është i vlefshëm kundrejt diplomës të shoqëruar me listën e notave, ndërsa kurset afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata janë të vlefshme kundrejt certifikatës/ dokumentit përkatës mbi kryerjen e tij.

4. Oficerët e specialiteteve, që kanë marrë një diplomë të arsimit të lartë (master profesional ose shkencor) të marrë jashtë vendit, duhet të bëjnë njohjen e tyre pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Vlerësimi i arsimit të lartë bëhet sipas notës mesatare të diplomës. Evidentimi i kurseve dhe hedhja e pikëve në sistemin e automatizuar të të dhënave bëhet nga QPR-ja.



5. Vlerësimi i diplomës së arsimit të lartë bëhet, si më poshtë:

$$\begin{aligned} \text{VDMp} &= \text{Nmes. x P no} \\ \text{VDMsh} &= \text{Nme. x pno} \\ \text{VAL} &= \text{VDMp} + \text{VDMsh} \\ \text{VAK} &= \text{VAL} + \text{VKAFSH/VSP} + \text{VKAFM} + \text{VKAGJ} \end{aligned}$$

6. Llogaritja e pikëve administrative për këtë kategori ushtarakësh bëhet, si më poshtë:

$$\text{PA} = \text{VAK} + \text{VGJA} + \text{VGJHT} + \text{VTF} + \text{VM\&D}$$

7. Vlerësimi nga komisionet e karrierës dhe llogaritja e pikëve për këtë kategori, bëhet sipas nenit 33, 34 dhe 35 të kësaj rregulloreje.

Neni 32

Vlerësimi i arsimimit dhe kualifikimit për nënoficerët e që mbajnë gradën OR5-OR8

- Vlerësimi i kësaj kategorie të nënoficerëve bëhet duke pasur parasysh kërkesat e nenit 21, pika 1, të ligjit nr. 59, datë 12.06.2014 "Për karrierën e ushtarakut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 15/2021 dhe nevojat organike. Vlerësimi i pikëve administrative për nënoficerët e specialiteteve, përveç treguesve të nenit 25, 26, 27, 28, dhe 29 të kësaj rregulloreje përfshin edhe vlerësimin e diplomave/certifikatave të marra/kryera gjatë kohës së qëndrimit në gradë, si më poshtë:
 - vlerësimin e arsimit të lartë në fushën e specialitetit;
 - vlerësimin e kurseve funksionale në fushën e specialitetit, brenda kohës së qëndrimit në gradë;
 - vlerësimin e kursit institucional, nëse e ka kryer.
- Treguesit e vlerësimit dhe sasia e pikëve për secilin tregues përcaktohen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 6

Nr.	Treguesit e vlerësimit	Sasia e pikëve	Kohëzgjatja
Pikët administrative			
1	Diploma e arsimit të lartë	6	
2	Arsimi i mesëm profesional	2	
3	Kursi institucional, nëse është kryer	6	
4	Kurset afatshkurtra (brenda kohës së qëndrimit në gradë)	2	>1-3 muaj
5	Kurset afatmesme (brenda kohës së qëndrimit në gradë)	4	>3-6 muaj
6	Kurset afatgjata (brenda kohës së qëndrimit në gradë)	6	>6 muaj-2 vjet

- Vlerësimi i diplomës së arsimit të lartë dhe i shkollës së mesme profesionale në fushën e specialitetit bëhet në bazë të diplomës përkatëse dhe notës mesatare.
- Vlerësimi i kurseve funksionale në fushën përkatëse bëhet në bazë të certifikatës që vërteton kryerjen e tij.
- Vlerësimi i arsimit të lartë dhe i shkollës së mesme profesionale në fushën e specialitetit bëhet, si më poshtë:

$$\text{VDAL\&VSHM} = \text{Nmes.x pno}$$

$$\text{VAK} = \text{VKI} + \text{VDAL} + \text{VDSHM} + \text{VKAFSH} + \text{VKAFM} + \text{VKAGJ}$$

- Vlerësimi i treguesve të tjerë bëhet siç përcaktohet në këtë rregullore, për të gjithë ushtarakët e tjerë.
- Llogaritja e pikëve administrative për këtë kategori ushtarakësh bëhet, si më poshtë:

$$\text{PA} = \text{VAK} + \text{VGJA} + \text{VGJHT} + \text{VTF} + \text{VM\&D}$$



8. Vlerësimi nga komisionet e karrierës dhe llogaritja e pikëve për këtë kategori, bëhet sipas nenit 31, 32 dhe 33 të kësaj rregulloreje. Për këtë kategori ushtarakësh nuk aplikohet intervista.

Neni 33

Vlerësimi i komisioneve të karrierës (VKK)

1. Komisionet e karrierës vlerësojnë elementet e mëposhëm:
 - a) performanca në kryerjen e detyrës gjatë kohës së qëndrimit në gradë;
 - b) detyrat funksionale, që ushtaraku ka kryer gjatë kohës së qëndrimit në gradë;
 - c) intervista.
2. Sasia maksimale e pikëve të komisioneve të karrierës është e ndryshme për kategori të ndryshme ushtarakësh dhe grada të ndryshme (lidhja I).

Neni 34

Vlerësimi i performancës gjatë kohës së qëndrimit në gradë (VPerf.)

1. Vlerësimi i performancës është një nga elementet më të rëndësishme të vlerësimit të ushtarakut për promovim. Vlerësimi i saj bëhet duke u mbështetur në raportet e vlerësimeve vjetore të punës.
2. Për efekt vlerësimi do të merren në konsideratë raportet e vlerësimeve të punës të të gjitha viteve të qëndrimit në gradë, por jo më shumë se 4 vlerësime të plota ose të pjesshme, duke filluar nga vlerësimi më i fundit.
3. QPR-ja është përgjegjëse për evidentimin e rezultateve të vlerësimeve vjetore të ushtarakëve për periudhën e qëndrimit në gradën që mbajnë.
4. Për efekt llogaritje të pikëve për promovim në raportet e vlerësimit do të merret parasysh vlerësimi i eprorit më të lartë (vlerësimi përfundimtar).
5. Vlerësimi i performancës nga komisionet e karrierës do të bëhet sipas rregullit të mëposhtëm:
 - a) ushtaraku që në vlerësimin vjetor të punës ka vlerësimin "shkëlqyeshëm" do të vlerësohet me 5 deri 6 pikë;
 - b) ushtaraku që ka një vlerësim "shumë mirë" do të vlerësohet me 3 deri 4 pikë;
 - c) ushtaraku që ka një vlerësim "kënaqshëm" do të vlerësohet me 1 deri 2 pikë;
 - ç) ushtaraku që ka një vlerësim "jo gjithmonë i përshtatshëm" do të vlerësohet me 0 (zero) pikë.
6. Diferenca e pikëve të vlerësimit të anëtarëve të komisionit nuk duhet të jetë më e madhe se 1 (një) pikë, në të kundërt votimi përsëritet.
7. Llogaritja e pikëve për vlerësimin e performancës së një Viti (ose një periudhe të caktuar) bëhet sipas formulës;

$$Vp1 = [(VA1 + VA2 + VA3 + VA4 + \dots + VA7) / 7 \times P(36)] / 6, \text{ ku:}$$

- Vp1- vlerësimi i performancës së një viti;
- VA1...7- vlerësimi vjetor i punës nga anëtari 1 deri 7
- 7 - numër i anëtarëve të komisionit;
- P - sasia maksimale e pikëve që mund të vlerësohet ushtaraku;
- 6 - vlerësimi maksimal;

Sipas kësaj formule llogariten pikët për të gjitha vlerësimet vjetore të punës që ka ushtaraku gjatë kohës së qëndrimit në gradë.

8. Llogaritja e pikëve të përgjithshme të performancës bëhet sipas formulës;

$$VPP = (Vp1 + Vp2 + Vp3 + Vpn) / n, \text{ ku:}$$

- VPP - vlerësimi i përgjithshëm i performancës;



- Vp1...n- vlerësimi i performancës për çdo vlerësim vjetor;
- n - numrin e vlerësimeve vjetore.

Neni 35

Vlerësimi i detyrave funksionale (VDF)

1. Vlerësimi i detyrës funksionale kryhet pavarësisht nga rezultatet e arritura nga ushtaraku gjatë kryerjes së saj.
2. Për efekt vlerësimi detyrat funksionale, që oficeri ka kryer gjatë kohës së qëndrimit në gradën që mban, janë grupuar në tri kategori, si në tabelën 7.

Tabela 7

Nr.	Llojet e detyrave ose funksioneve që ushtaraku ka kryer gjatë kohës së qëndrimit në gradën që mban.	Sasia e pikëve
1	Komandant, zv/komandant, Shef shtabi në të gjitha nivelet e komandimit sipas gradës dhe funksione të tjera që njësohen me to. Drejtor, këshilltar në Kabinet, zv/drejtor, Shef qendre, oficer shtabi/përgjegjës sektori në MM dhe SHPFA, përfaqësues, zv/përfaqësues, oficer shtabi në shtabet e NATO-s, pedagog, atashe dhe funksione të tjera që njësohen me to,	4.5 deri 6
2	Shef dege/shef sektori/përgjegjës sektori/shef grupi në AFA, shef seksioni, shef zyre, komandant grupi, në të gjitha nivelet. Oficer shtabi/oficer planëzues në të gjitha nivelet, Shef departamenti, administrator, specialist në MM dhe SHPFA, këshilltar, mjek, drejtues teknik, si dhe funksione të tjera që njësohen me to.	4 deri 5.5
3	Specialist në të gjitha nivelet, jurist, inspektor, analist, adjutant/sekretar, asistent, psikolog, instruktor, koordinator, dispeçer, pilot, infermier, kryeinfermier, farmacist, kontrollor, kryekontrollor, inxhinier, arkitekt, vlerësues, oficer sigurie, oficer informacioni/drejtimi, oficer i policisë gjyqësore, oficer teknik aviacioni, kryeinxhinier, programues dhe zhvillues aplikacioni, mbikëqyrës, media analist dhe funksione të tjera që njësohen me to.	3 deri 4.5

3. Për efekt vlerësimi detyrat që nënoficeri ka kryer gjatë kohës së qëndrimit në gradën që mban janë grupuar në tri kategori, si në tabelën 8.

Tabela 8

Nr.	Llojet e detyrave ose funksioneve që nënoficeri ka kryer gjatë kohës së qëndrimit në gradën që mban.	Sasia e pikëve
1	Nënoficer i komandantit / këshilltar për nënoficerët në të gjitha nivelet e komandimit; komandant kursi, zv/komandant toge, nënoficerët e kompanive të aksioneve direkte në Forcat Speciale, nënoficerët që shërbejnë në kompanitë komando në batalionin komando, nënoficerët që shërbejnë në kompaninë EOD në Komandën Mbështetëse, nënoficerët që shërbejnë në togën EOD/IED në Forcën Tokësore, nënoficerët që shërbejnë në kompaninë MADM të Forcës Tokësore dhe nënoficerët që shërbejnë në grupet e zhytjes në Qendrën e zhytjes në Forcën Detare.	4.5 deri 6
2	Nënoficer në fushat bazë të drejtimit J1-9, G1-9, S1-9 Komandant skuadre, komandant grupi, komandant mortaje, komandant rakete, komandant/radist, komandant PRT, instruktor/pedagog, kryeteknik, kryespecialist, kryeinfermier, nënoficer orkestre, nënoficer në qpr, përgjegjës dhe funksione të tjera të njësuar me to. Shef oficine, shef seksioni, shef qendre, shef grupi, shef radiostacioni, shef strukture, shef VKT, nënoficer qendre, në të gjitha nivelet, si dhe funksione të tjera të njësuar me to.	4 deri 5.5
3	Specialist në të gjitha nivelet, snajperist, palombar, agent, analist, administrator, magazinier, llogaritar, operator, shofer, motorist, teknik, mirëmbajtës rrjeti, ekspeditor, elektrikist, kamerier, grumbullues informacioni, truproje nderi, përkthyes, infermier, asistent, laborant, instrumentist, polic, xhenerik, vrojtues, radist, mitraljer, adjutant, rojë, kuzhinier, luftues dhe shpëtues, ç'ndotës, dispeçer, kameraman, koordinator, manovrator, ndihmësshënjesues, recepsionist, gurahedhës, zjarrfikës, sekretar dhe funksione të tjera të njësuar me to.	3 deri 4.5

4. Vlerësimi bëhet për të gjitha detyrat me kohëzgjatje jo më të vogël se 6 muaj, që ushtaraku ka kryer gjatë kohës së qëndrimit në gradë, por jo më shumë se 4 detyra dhe jo më parë se 6 vitet e fundit, referuar datës 01 qershor për personelin që shqyrtohet për kualifikimin e rradhës, dhe datës 01 tetor për personelin që shqyrtohet për marrjen e gradës së rradhës. Përzgjedhja dhe vendosja e detyrave funksionale, sipas kategorive të përcaktuara në tabelën 7 dhe 8, bëhet nga QPR-ja në bazë të evidentimit të detyrave në dosjen personale të ushtarakut. Në vlerësimin e detyrave funksionale, komisioni vlerëson me pikë detyrën, duke u nisur nga rëndësia e saj dhe jo performancën.
5. Vlerësimi i detyrës funksionale nga çdo anëtar i komisionit bëhet sipas tabelës 7 dhe 8.
6. Përlllogaritja e pikëve të siguruara nga vlerësimi i detyrave funksionale bëhet sipas formulës:

$$\text{VDF } 1-n = (\text{VA1} + \text{VA2} + \dots + \text{VA7})/7, \text{ ku:}$$

- VDF1-n- vlerësimi i detyrave nga komisioni;
- VA1....7- vlerësimi nga çdo anëtar;
- 7- numri i anëtarëve të komisionit.

7. Përlllogaritja e pikëve të përfituara nga vlerësimi i dy detyrave bëhet sipas formulës:

$$\text{VDF} = [(\text{VDF1} + \text{VDF2} + \text{VDFn})/n] \times P/6$$

- P- pikët maksimale që mund të merren nga vlerësimi i detyrave;
- 6- pikët maksimale të vlerësimit të çdo detyre.

8. Në rast se diferenca midis rezultatit më të lartë dhe rezultatit më të ulët të vlerësimit të secilit anëtar komisioni është më e madhe se 1 (një) pikë, atëherë vlerësimi përsëritet.

Neni 36

Intervista me pyetje

1. Intervista me pyetje do të aplikohet vetëm për oficerët që mbajnë gradën kapiten e lart. Ajo do të zhvillohet vetëm për vlerësimin e ushtarakëve për përparimin në gradë.
2. Intervista fillon me vetprezantimin pastaj zhvillohet në formën pyetje-përgjigje. Ajo zhvillohet në shqip dhe anglisht dhe ka 8 pikë.
3. Qëllimi i saj është të verifikojë njohuritë që kandidati ka për:
 - a. Forcat e Armatosura, organizimin, misionin dhe detyrat e tyre;
 - b. NATO-n, organizimi dhe roli i saj për paqen dhe sigurinë;
 - c. Procesin e planëzimit operacional;
 - ç. Legjislacionin ushtarak, duke përfshirë ligjin për karrierën ushtarake në FA; ligjin për disiplinën ushtarake në FA, ligjin për pushtetet dhe autoritetet në FA, statusin e ushtarakut, rregulloret bazë ushtarake, rregulloren për vlerësimet vjetore të punës;
 - d. si dhe për çështje të tjera specifike sipas specialitetit të të intervistuarit.
4. Fondi i pyetjeve përgatitet nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura sipas fushës së përgjegjësisë dhe përbëhet nga 20 pyetje nga secila prej rubrikave të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni. Përgjashtimisht për rubrikën e përcaktuar në shkronjën "d" të pikës 3 të këtij neni, përgatiten nga 20 pyetje për çdo specialitet që konkurren për marrjen e gradës së rradhës.
5. Pyetjet për rubrikën e përcaktuar në shkronjën "b" të pikës 3, të këtij neni formulohen dhe i adresohen kandidatit në anglisht.



6. Pyetjet janë publike dhe afishohen në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes të paktën 30 ditë para nisjes së punës së KLK-së.
7. Çdo pyetje i vihet një kod unik, asocimi i të cilave disponohet nga KLK-ja. KLK-ja disponon në formë të shkruar dhe përgjigjet për secilën pyetje.
8. Çdo i intervistuar zgjedh nga një zarf të mbyllur për secilën rubrikë dhe kodin unik që gjendet në zarf ja paraqet KLK-së. Kryetari i KLK-së i adreson kandidatit pyetjet e përzgjedhura.
9. Me ushtarakët që janë jashtë vendit dhe konkurrojnë për manjen e gradës së radhës, intervista me pyetje do të zhvillohet nëpërmjet telekonferencës dhe në pamundësi, nëpërmjet komunikimit telefonik. Përzgjedhja e pyetjeve sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen do të bëhet nga Kryetari i KLK-së.
10. Vlerësimi i pyetjeve bëhet në mënyrë të pavarur nga çdo anëtar i komisionit. Çdo pyetje vlerësohet nga 1-5 pikë, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në tabelën 9.
11. Kriteret e vlerësimit të pyetjeve janë:
 - saktësia, qartësia, kuptueshmëria, vizioni, strukturimi i mendimeve dhe respektimi i kohës;
 - korrektesa, shkalla e përqendrimit, aftësitë komunikuese dhe niveli i njohjes së gjuhës angleze;
 - përditësimi i informacionit, etika e komunikimit dhe shkalla e njohjes së ligjeve.
12. Fondi i pyetjeve përgatitet dhe përditësohet cdo vitë dhe jo më larg se data 31 maj i cdo viti.

Tabela 9

	Vlerësimi intervistës	Kriteret e vlerësimit
1	1-1.99	Kur përgjigja e pyetjes ka karakter të përgjithshëm, është përgjithësisht i qartë dhe kuptueshëm dhe jo shumë i strukturuar në trajtimin e problemit. Nuk ka vizion të qartë, por është korrekt në përgjigje dhe brenda etikës.
2	2-2.99	Kur është i qartë, i saktë, i kuptueshëm dhe i strukturuar në mendime në mënyrë të kënaqshme, përgjigjet brenda kohës së caktuar dhe në përgjithësi është vizionar, është korrekt dhe ruan etikën.
3	3-3.99	Kur zotëron shumë mirë konceptet, integron dhe sintetizon mirë, në mënyrë intuitave dhe në mënyrë krijuese mbron argumentin. Në mënyrë konsistente është në gjendje të organizojë mendimet dhe në mënyrë efektive artikulon ide komplekse duke inkorporuar shembuj, analogji dhe referenca. Të jetë i qartë, i saktë, i kuptueshëm dhe i strukturuar mirë në mendime dhe përgjigjet brenda kohës së caktuar. Ka një vizion të mirë, është korrekt dhe ruan etikën.
4	4-5	Kur zotëron shkëlqyeshëm konceptet, integron dhe sintetizon rrjedhshëm, në mënyrë intuitave duke demonstruar aftësi të shkëlqyera të menduari dhe në mënyrë krijuese mbron argumentin. Në mënyrë konsistente dhe efikente është në gjendje të organizojë mendimet dhe në mënyrë efektive artikulon qartë ide komplekse duke inkorporuar logjikshëm shembuj, analogji dhe referenca. Të jetë shumë i qartë, i saktë, i kuptueshëm, konciz, dhe i strukturuar shumë mirë në mendime, përgjigjet brenda kohës së caktuar, është vizionar, korrekt dhe ruan etikën.

13. Vlerësimi i përgjigjeve të pyetjeve nga çdo anëtar llogaritet si mesatare e vlerësimit të pyetjeve.


$$VA1....7=(VP1+VP2+VP3+VP4)/4, \text{ ku:}$$

- VA1.....7-vlerësimi i pyetjeve nga çdo anëtar komisioni;
- 4 - sasia e pyetjeve;
- VP1-4- vlerësimi i pyetjes 1-4.

14. Vlerësimi i intervistës do të bëhet sipas formulës së mëposhtme:

$$VI=(VA1+VA2.....+VA7)/7 \times P/5 \text{ ku:}$$

- VA1-7-vlerësimi i anëtarëve të komisionit;
- 7 - numri i anëtarëve të komisionit;
- P - pesha e vlerësimit të intervistës;
- 5 - vlera maksimale e vlerësimit të intervistës.



15. Personeli i cili nuk paraqitet për intervistën me pyetje, vlerësohet me 0 (zero) pikë.
16. Në rast se diferenca midis rezultatit më të lartë dhe rezultatit më të ulët të vlerësimit individuale të secilit anëtar komisioni është më e madhe se 2 (dy) pikë, atëherë vlerësimi përsëritet.

Neni 37

Intervista për nënoficerët

- Intervista do të aplikohet vetëm për nënoficerët që mbajnë gradën rreshter e lart. Ajo do të zhvillohet vetëm për vlerësimin e ushtarakëve për përparimin në gradë.
- Intervista fillon me vetprezantimin pastaj zhvillohet në formën e një bashkëbisedimi pyetje-përgjigje. Ajo zhvillohet në shqip dhe anglisht dhe ka 8 pikë.
- Qëllimi i saj është të verifikojë njohuritë që kandidati ka për; Forcat e Armatosura, organizimin, misionin dhe detyrat e tyre; NATO, organizimi dhe roli i saj për paqen dhe sigurinë; procesin e planëzimit operacional në nivel taktik; ligjin për karrierën ushtarake në FA; ligjin për disiplinën ushtarake në FA, rregulloret baze ushtarake, rregulloren për vlerësimet vjetore të punës, etj.
- Me ushtarakët që janë jashtë vendit dhe konkurrojnë për marrjen e gradës së radhës intervista do të zhvillohet nëpërmjet video-konferencës, në pamundësi nëpërmjet komunikimit telefonik.
- Komisioni përgatit pyetjet para zhvillimit të intervistës.
- Vlerësimi i pyetjeve bëhet në mënyrë të pavarur nga çdo anëtar i komisionit. Çdo pyetje vlerësohet nga 1-5 pikë, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në tabelën 10.
- Kriteret e vlerësimit të pyetjeve janë:
 - saktësia, qartësia, kuptueshmëria, vizioni, strukturimi i mendimeve dhe respektimi i kohës;
 - korrektesa, shkalla e përqendrimit, aftësitë komunikuese dhe niveli i njohjes së gjuhës angleze;
 - përditësimi i informacionit, etika e komunikimit dhe shkalla e njohjes së ligjeve.

Tabela 10

Nr.	Vlerësimi i intervistës	Kriteret e vlerësimit
1	1-1.99	Kur përgjigja e pyetjes ka karakter të përgjithshëm, është përgjithësisht i qartë dhe kuptueshëm dhe jo shumë i strukturuar në trajtimin e problemit. Nuk ka vizion të qartë, por është korrekt në përgjigje dhe brenda etikës.
2	2-2.99	Kur është i qartë, i saktë, i kuptueshëm dhe i strukturuar në mendime në mënyrë të kënaqshme, përgjigjet brenda kohës së caktuar dhe në përgjithësi është vizionar, është korrekt dhe ruan etikën.
3	3-3.99	Kur është i qartë, i saktë, i kuptueshëm dhe i strukturuar mirë në mendime dhe përgjigjet brenda kohës së caktuar. Ka një vizion të mirë, është korrekt dhe ruan etikën.
4	4-5	Kur është shumë i qartë, i saktë, i kuptueshëm, konciz, dhe i strukturuar shumë mirë në mendime, përgjigjet brenda kohës së caktuar, është vizionar, korrekt dhe ruan etikën.

8. Vlerësimi i përgjigjeve të pyetjeve nga çdo anëtar llogaritet si mesatare e vlerësimit të pyetjeve.

$$VA1....7=(VP1+VP2+.... VPn)/n, \text{ ku:}$$

- VA1.....7-vlerësimi i pyetjeve nga çdo anëtar komisioni;
- n - sasia e pyetjeve;
- VP1- vlerësimi i pyetjes

9. Vlerësimi i intervistës do të bëhet sipas formulës së mëposhtme:

$$VI=(VA1+VA2+.....+VA7)/7 \times P/5 \text{ ku:}$$

- VA1-7-vlerësimi i anëtarëve të komisionit;
- 7 - numri i anëtarëve të komisionit;
- P - pesha e vlerësimit të intervistës;
- 5 - vlera maksimale e vlerësimit të intervistës.



10. Personeli i cili nuk paraqitet për intervistë, vlerësohet me 0 (zero) pikë;
11. Në rast se diferenca midis rezultatit më të lartë dhe rezultatit më të ulët të vlerësimit individuale të secilit anëtar komisioni është më e madhe se 2 (dy) pikë, atëherë vlerësimi përsëritet.
12. Me ushtarakët që janë jashtë vendit dhe konkurrojnë për marrjen e gradës së radhës, intervista do të zhvillohet nëpërmjet telekonferencës, në pamundësi nëpërmjet komunikimit telefonik.

Neni 38

Sasia e pikëve të siguruara nga vlerësimi i komisionit të karrierës

Sasia e pikëve të siguruara nga vlerësimi i komisionit të karrierës llogaritet sipas formulës:

$$PKK=VPerf+VDF+VI$$

Neni 39

Llogaritja e përgjithshme e pikëve

Sasia e përgjithshme e pikëve për promovim llogaritet si shumë e pikëve administrative dhe pikëve të komisionit të karrierës.

$$PP=PA+PKK, \text{ ku:}$$

- PP- pikët e përgjithshme;
- PA-pikët administrative;
- PKK-pikët e komisioneve të karrierës.

KREU V

VLERËSIMI I OFICERËVE DHE NËNOFICERËVE PËR NDJEKJEN E KURSEVE INSTITUCIONALE

Neni 40

Kriteret dhe metodologjia e vlerësimit për ndjekjen e kurseve institucionale

1. Për vlerësimin e oficerëve, që u ka lindur e drejta për ndjekjen e kurseve institucionale, zbatohen të njëjtat kriteret dhe metodologji si për vlerësimin për përparimin në gradë të oficerëve, lidhja 1.
2. Për vlerësimin e nënoficerëve, që u ka lindur e drejta për ndjekjen e kurseve institucionale, zbatohen të njëjtat kriteret dhe metodologji si për vlerësimin për përparimin në gradë të nënoficerëve, lidhja 2.
3. Për vlerësimin e oficerëve dhe nënoficerëve për ndjekjen e kurseve institucionale nuk aplikohet intervista.

Neni 41

Shkurtimet

Shkurtimet e përdorura në këtë rregullore dhe kuptimi i tyre jepen në lidhjen 6.



KRITERET PËR PËRPARIMIN NË GRADË TË OFICERËVE

Gradat	Kriteret e pranimit nga komisionet
1. Nëntoger	- të ketë plotësuar kohën minimale të qëndrimit në gradë, 3 vjet; - të ketë kryer "Kursin bazë të oficerit" ose kurse të njësuar me të; - të ketë më shumë se gjysmën e vlerësimeve vjetore gjatë viteve të qëndrimit në gradën që mban të vlerësuar jo më poshtë se "kënaqshëm"; - të jetë i aftë fizikisht dhe të jetë deklaruar i aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - të mos kanë plotësuar moshën maksimale të qëndrimit në shërbimin aktiv, sipas neneve 14 e 14/1 të ligjit nr. 59/2014, i ndryshuar
2. Toger	- të ketë plotësuar kohën minimale të qëndrimit në gradë, 4 vjet. - të ketë kryer "Kursin e avancuar të oficerit" ose kurse të njësuar me të. - të ketë më shumë se gjysmën e vlerësimeve vjetore gjatë viteve të qëndrimit në gradën që mban të vlerësuar jo më poshtë se "kënaqshëm". - të jetë i aftë fizikisht dhe të jetë deklaruar i aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - të mos kanë plotësuar moshën maksimale të qëndrimit në shërbimin aktiv, sipas neneve 14 e 14/1 të ligjit nr. 59/2014, i ndryshuar
3. Kapiten	- të ketë plotësuar kohën minimale të qëndrimit në gradë, 5 vjet; - të ketë kryer "Kursin themelor të oficerit të shtabit" ose kurse të njësuar me të; - të ketë më shumë se gjysmën e vlerësimeve vjetore gjatë viteve të qëndrimit në gradën që mban të vlerësuar jo më poshtë se "kënaqshëm"; - të jetë i aftë fizikisht dhe të jetë deklaruar i aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - të jetë jo më pak se 34 vjeç, deri më 31 dhjetor - të mos kanë plotësuar moshën maksimale të qëndrimit në shërbimin aktiv, sipas neneve 14 e 14/1 të ligjit nr. 59/2014, i ndryshuar
4. Major	- të ketë plotësuar kohën minimale të qëndrimit në gradë, 5 vjet; - të ketë kryer "Kursin e Komandës dhe Shtabit (KKSH)" ose kurse të njësuar me të; - të ketë më shumë se gjysmën e vlerësimeve vjetore gjatë viteve të qëndrimit në gradën që mban të vlerësuar jo më poshtë se "kënaqshëm"; - të jetë i aftë fizikisht dhe të jetë deklaruar i aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - të jetë jo më pak se 40 vjeç deri më 31 dhjetor - të mos kanë plotësuar moshën maksimale të qëndrimit në shërbimin aktiv, sipas neneve 14 e 14/1 të ligjit nr. 59/2014, i ndryshuar
5. Nënkolonel	- të ketë plotësuar kohën minimale të qëndrimit në gradë, 5 vjet; - të ketë kryer "Kursin e lartë të oficerit të shtabit" ose kurse të njësuar me të; - të ketë më shumë se gjysmën e vlerësimeve vjetore gjatë viteve të qëndrimit në gradën që mban të vlerësuar jo më poshtë se "kënaqshëm"; - të jetë i aftë fizikisht dhe të jetë deklaruar i aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - të jetë jo më pak se 45 vjeç deri më 31 dhjetor - të mos kanë plotësuar moshën maksimale të qëndrimit në shërbimin aktiv, sipas neneve 14 e 14/1 të ligjit nr. 59/2014, i ndryshuar



KRITERET PËR PËRPARIMIN NË GRADË TË NËNOFICERËVE

Gradat	Kriteret e pranimit nga komisionet
1. Nëntetar	- të ketë plotësuar kohën minimale të qëndrimit në gradë, 3 vjet; - të ketë kryer "Kursin bazë të nënoficerit" ose kurse të njësuara me të; - të ketë më shumë se gjysmën e vlerësimeve vjetore gjatë viteve të qëndrimit në gradën që mban të vlerësuara jo më poshtë se "kënaqshëm"; - të jetë i aftë fizikisht dhe të jetë deklaruar i aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - të mos kanë plotësuar moshën maksimale të qëndrimit në shërbimin aktiv, sipas neneve 14 e 14/1 të ligjit nr. 59/2014, i ndryshuar.
2. Tetar	- të ketë plotësuar kohën minimale të qëndrimit në gradë, 4 vjet; - të ketë kryer "Kursin e avancuar të nënoficerit" ose kurse të njësuara me të; - të ketë më shumë se gjysmën e vlerësimeve vjetore gjatë viteve të qëndrimit në gradën që mban të vlerësuara jo më poshtë se "kënaqshëm"; - të jetë i aftë fizikisht dhe të jetë deklaruar i aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - të mos kanë plotësuar moshën maksimale të qëndrimit në shërbimin aktiv, sipas neneve 14 e 14/1 të ligjit nr. 59/2014, i ndryshuar.
3. Rreshter	- të ketë plotësuar kohën minimale të qëndrimit në gradë, 6 vjet; - të ketë kryer "Kursin e lartë të nënoficerit" ose kurse të njësuara me të. - të ketë më shumë se gjysmën e vlerësimeve vjetore gjatë viteve të qëndrimit në gradën që mban të vlerësuara jo më poshtë se "kënaqshëm"; - të jetë i aftë fizikisht dhe të jetë deklaruar i aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - të mos kanë plotësuar moshën maksimale të qëndrimit në shërbimin aktiv, sipas neneve 14 e 14/1 të ligjit nr. 59/2014, i ndryshuar.
4. Kapter	- të ketë plotësuar kohën minimale të qëndrimit në gradë, 5 vjet; - të ketë kryer "Kursin e kryekapit" ose kurse të njësuara me të; - të ketë më shumë se gjysmën e vlerësimeve vjetore gjatë viteve të qëndrimit në gradën që mban të vlerësuara jo më poshtë se "kënaqshëm"; - të jetë i aftë fizikisht dhe të jetë deklaruar i aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - të mos kanë plotësuar moshën maksimale të qëndrimit në shërbimin aktiv, sipas neneve 14 e 14/1, të ligjit nr. 59/2014, i ndryshuar.



KRITERET E PRANIMIT PËR NDJEKJEN E KURSEVE INSTITUCIONALE NGA OFICERËT

Grada Kursi	Kriteret e pranimit në kurset institucionale.
Togeri KURSI I AVANCUAR I OFICERIT	Ky kurs u ofrohet të gjithë oficerëve që mbajnë gradën "toger", të cilët: - të mos kenë asnjë vlerësim në dy vitet e fundit, të vlerësuara jo më pak se "shumë mirë"; - të jenë të aftë fizikisht dhe të jenë deklaruar të aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - kanë kryer "Kursin bazë të oficerit", me përjashtim të specialiteteve të përcaktuara me VKM; - kanë jo më pak se 2 vjet nga koha e marrjes së gradës toger dhe u kanë mbetur jo më pak se 1 vit për të plotësuar moshën e përcaktuar, sipas pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 59, datë 12.6.2014 "Për karrierën e ushtarakut në FA në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për daljen në rezervë.
Kapiteni KURSI THEMELOR I OFICERIT SHTABIT	Ky kurs u ofrohet të gjithë oficerëve që mbajnë gradën "kapiten", të cilët: - të mos kenë asnjë vlerësim në dy vitet e fundit, të vlerësuara jo më pak se "shumë mirë"; - të jenë të aftë fizikisht dhe të jenë deklaruar të aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - kanë kryer "Kursin e avancuar të oficerit", me përjashtim të specialiteteve të përcaktuara me VKM; - kanë jo më pak se 2 vjet nga koha e marrjes së gradës kapiten dhe u kanë mbetur jo më pak se 1 vit për të plotësuar moshën e përcaktuar, sipas pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 59, datë 12.6.2014 "Për karrierën e ushtarakut në FA në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për daljen në rezervë.
Major KURSI I KOMANDËS DHE SHTABIT	Ky kurs u ofrohet oficerëve që mbajnë gradën "major", të cilët: - të mos kenë asnjë vlerësim në dy vitet e fundit, të vlerësuara jo më pak se "shumë mirë". - të jenë të aftë fizikisht dhe të jenë deklaruar të aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - kanë kryer KTHOSH-në, me përjashtim të specialiteteve të përcaktuara me VKM; - kanë jo më pak se 3 vjet nga koha e marrjes së gradës major dhe u kanë mbetur jo më pak se 4 vjet për të plotësuar moshën e përcaktuar, sipas pikës 1, nenit 14, të ligjit nr. 59, datë 12.6.2014 "Për karrierën e ushtarakut në FA në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për daljen në rezervë.
Nënkolonel KURSI I LARTË I OFICERIT	Ky kurs u ofrohet oficerëve që mbajnë gradën "nënkolonel", të cilët: - të mos kenë asnjë vlerësim në dy vitet e fundit, të vlerësuara jo më pak se "shumë mirë"; - të jenë të aftë fizikisht dhe të jenë deklaruar të aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - kanë kryer KKSHP-në me përjashtim të specialiteteve të përcaktuara me VKM; - kanë jo më pak se 2 vjet nga koha e marrjes së gradës nënkolonel dhe u kanë mbetur jo më pak se 4 vjet për të plotësuar moshën e përcaktuar, sipas pikës 1, nenit 14, të ligjit nr. 59, datë 12.6.2014 "Për karrierën e ushtarakut në FA në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për daljen në rezervë.



KRITERET E PRANIMIT PËR NDJEKJEN E KURSEVE INSTITUCIONALE NGA NËNOFICERËT

Gradat Kurset	Kriteret e pranimit në kurset institucionale
Nëntetar KURSI BAZË I NËNOFICERIT	Ky kurs u ofrohet të gjithë nënoficerëve që mbajnë gradën "nëntetar", të cilët: - të mos kenë asnjë vlerësim në dy vitet e fundit, të vlerësuara jo më pak se "kënaqshëm"; - të jenë të aftë fizikisht dhe të jenë deklaruar të aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - kanë kryer "Kursin fillestar të nënoficerit", me përjashtim të specialiteteve të përcaktuara me VKM; - kanë jo më pak se 2 vjet që mbajnë gradën nëntetar dhe nuk e kanë kaluar moshën e përcaktuar sipas pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 59, datë 12.6.2014 "Për karrierën e ushtarakut në FA në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për daljen në rezervë.
Tetar KURSI AVANCUAR I NËNOFICERIT	Ky kurs u ofrohet të gjithë nënoficerëve që mbajnë gradën "tetar" të cilët: - të mos kenë asnjë vlerësim në dy vitet e fundit, të vlerësuara jo më pak se "kënaqshëm". - të jenë të aftë fizikisht dhe të jenë deklaruar të aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - kanë kryer "Kursin bazë të nënoficerit" (ANO + SHT), me përjashtim të specialiteteve të përcaktuara me VKM; - kanë jo më pak se 2 vjet që mbajnë gradë "tetar" dhe nuk e kanë kaluar e përcaktuar, sipas pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 59, datë 12.6.2014 "Për karrierën e ushtarakut në FA në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për daljen në rezervë.
Rreshter KURSI LARTË I NËNOFICERIT	Ky kurs u ofrohet nënoficerëve që mbajnë gradën "rreshter", të cilët: - të mos kenë asnjë vlerësim në dy vitet e fundit, të vlerësuara jo më pak se "kënaqshëm". - të jenë të aftë fizikisht dhe të jenë deklaruar të aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - kanë kryer "Kursin e avancuar të nënoficerit" (ANO + SHT); - kanë jo më pak se 3 vjet që mbajnë gradën "rreshter" dhe u kanë mbetur jo më pak se 4 vjet për të plotësuar moshën e përcaktuar, sipas pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 59, datë 12.6.2014 "Për karrierën e ushtarakut në FA në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për daljen në rezervë.
Kapteri KURSI I KRYEKAPTERIT	Ky kurs u ofrohet nënoficerëve që mbajnë gradën "kapter", të cilët: - të mos kenë asnjë vlerësim në dy vitet e fundit, të vlerësuara jo më pak se "Shumë mirë" - të jenë të aftë fizikisht dhe të jenë deklaruar të aftë nga ana shëndetësore nga ana e Komisionit Mjekoligjor; - kanë kryer "Kursin e lartë të nënoficerit". - kanë jo më pak se 3 vjet që mbajnë gradën kapter dhe u kanë mbetur jo më pak se 4 vjet për të plotësuar moshën e përcaktuar, sipas pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 59, datë 12.6.2014 "Për karrierën e ushtarakut në FA në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për daljen në rezervë.





Njoftim

(Grada, Emri, Atësia, Mbiemri) është vlerësuar nga Komisioni i _____ i Karrierës për Vitin _____ dhe në përfundim është vlerësuar me _ (pikë) të ndarë sipas rubrikave të mëposhtme:

Nr.	Lloji i vlerësimit	Sasia e pikëve
	Pikët administrative	
1.	Vlerësimi për kursin institucional	
2.	Vlerësimi i arsimit të lartë	
3.	Vlerësim për gjuhën angleze	
4.	Vlerësimi për gjuhët e tjera	
5.	Vlerësimi i testit fizik	
6.	Vlerësimi i Medaljeve dhe dekoratave	
	Shuma e pikëve administrative	
	Vlerësimi i Komisionit të Karrierës	
1.	Vlerësimi i performancës	
2.	Vlerësimi për detyrat funksionale	
3.	Vlerësimi i intervistës	
	Shuma e pikëve të Komisionit të Karrierës	
	Pikët totale	
	Pozicionimi në listën e meritës	

Shënim: Për vlerësimin e oficerëve dhe nënoficerëve të mjekësisë dhe orkestrës frymore njoftimi duhet të përmbajë edhe treguesit e tjerë të vlerësimit

Kryetari i Komisionit të Karrierës

Grada, Emri, Mbiemri

Nënshkrimi

Tiranë, më ____/____/____.



SHKURTIMET

KKK&KZK- Komisioni i Lartë i Karrierës dhe Komisionet e Zakonshme të Karrierës
 QPR- Qendra e Personel-Rekrutimit
 J-I -Drejtoria e Personelit
 MM-Ministria e Mbrojtjes
 SHPFA- Shtabi i Përgjithshëm i FA-së
 AFA- Akademia e Forcave të Armatosura
 KDS- Komanda e Doktrinës dhe Stërviçjes
 DMBNJSH- Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
 KI- Kursi institucional
 GJH-Gjuha e huaj
 GJA-Gjuha angleze
 GJHT-Gjuhët e huaja të tjera
 TUPF- Testi i përgatitjes fizike ushtarake
 M&D- Medaljet dhe dekoratat
 DF- Detyra funksionale
 VVP- Vlerësimet vjetore të punës
 I- Intervista
 VAK- Vlerësimi i arsimim - kualifikim
 VKI- Vlerësimi i kursit institucional
 VKF- Vlerësimi i kursit funksional VKAFSH-
 Vlerësimi i kursit afatshkurtër
 VKAFM-Vlerësimi i kursit afatmesëm
 VKAFGJ-Vlerësimi i kursit afatgjatë
 VKSPPU- Vlerësimi i kursit të specializimit të plotë pasuniversitar
 VGJH- Gjuhët e huaja
 VGJA-Vlerësimi i gjuhës angleze
 VGJHT-Vlerësimi i gjuhëve të huaja të tjera
 VTF- Vlerësimi i testimit fizik
 VM&D-Vlerësimi i medaljeve dhe dekoratave
 Vperf-Vlerësimi i performancës
 VDF-Vlerësimi i detyrave funksionale
 VI-Vlerësimi i intervistës
 PA-Pikët administrative
 Nmes.- Nota mesatare
 P- Peshë e faktorit/sasia e pikëve të treguesve të vlerësimit .
 VKK- Vlerësimi i komisioneve të karrierës
 SABNJ- Sistemi i automatizuar i burimeve njerëzore
 Vpl -Vlerësimi vjetor i punës për 1 (një) vit VAI7-
 Vlerësimi nga anëtarët e komisionit 17 VPP-
 Vlerësimi i përgjithshëm i performancës n- Numri i
 vlerësimeve vjetore të punës
 VDFI....7- Vlerësimi i detyrave funksionale nga anëtarët e komisionit 1....7
 PKK-pikët e siguruar nga vlerësimi i Komisionit të Karrierës .PA-Pikët
 administrative

